

Mr Muhamet Shatri

BRIGADA IV KOSOVARE

Në pranverën e vitit 1944, në Malësi, në Has, në Lumë dhe në viset jugore të Dukagjinit u krijuan kushte të favorshme për zhvillimin e LNÇ. Ky territor u shndërrua në njerën nga bazat më të sigurta për strehimin, formimin dhe pajisjen e formacioneve të rregullta të UNÇ dhe të AP të Kosovës. Në këtë sektor u bë tërheqja e luftëtarëve nga Rrafshi i Dukagjinit dhe inkuadrimi i tyre në njësitet dhe formacionet që u formuan në vigjiljen e luftës përfundimtare për çlirimin e mbarë Kosovës. Në qershor të vitit 1944 u formua batalioni »Kosova«, i cili në Dukagjin dhe Shqipërinë e Veriut ndërmorri një serë aksionesh të guximshme luftarake kundër okupatorit gjerman dhe bashkëpunëtorëve të tij.¹

Në masivizimin dhe popullarizimin e LNÇ në këtë trevë rol të rëndësishëm luajti batalioni »Kosova«. Në këtë drejtim kontribuan edhe Çeta e Hasit si dhe njësitet e tjera të këtyre anëve. Andaj, aktiviteti i këtyre formacioneve, si dhe krijimi i territorit të lirë, qenë parakusht themelor për formimin e formacioneve më të mëdha të armatosura.² Formimin e tyre e diktuan, pos rrethanave të përmendura, edhe ato të natyrës taktike ushtarake. Njësitet partizane më të vogla ishin të lidhura për një terren të caktuar dhe nuk kishin mundësi të zhvillonin operacione luftarake dhe njëkohësisht t'u iknin ofensivave të formacioneve më të mëdha të armikut. Prandaj, për zgjerimin e mëtejme të kryengritjes dhe shndërrimin e saj në luftë të përgjithshme popullore ishin të nevojshme ndryshime kuantitative dhe kualitative në organizimin dhe aftësimin e forcave të armatosura.

Kjo u arrit pikërisht me formimin e brigadave, të cilat, përnga struktura, ishin njësi të lëvizshme, të afta për manevrime në çfarëdo terreni. Prandaj, formimi i tyre shënon fillimin e këtyre ndryshimeve dhe kalimin e LNÇ në fazën më të lartë të masivizimit.³

I. Formimi i Brigadës

Brigada IV Kosovare u formua në Krumë të Hasit (Shqipëri) më 13. X. 1944. Si pikëmbështetje dhe bërthamë për formimin e kësaj brigade shërbeu Batalioni »Kosova« dhe një pjesë e luftëtarëve dhe e kuadrit.

¹ Jubileu i Brigadës IV Sulmuese të Kosovës, »Rilindja« 13. X. 1979.

² Po aty.

³ *Vojna Enciklopedija*, nr. 7, 1971, Beograd, fq. 28.

komandues të Brigadës I, Brigada IV u formua në praninë e Brigadës III dhe V të UNÇ të Shqipërisë. Ajo në fillim kishte 400 luftëtarë, kurse më vonë efektivet e saj rritën në më se 2000 veta. Në fillim një e treta e luftëtarëve nuk kishte armë, ndërsa pjesa tjetër ishte e pajisur me armë të zëna nga armiku. Pos kësaj, burim furnizimi qenë pajimet që vinin nga Italia e të cilat Shtabi Suprem ia kishte lënë në dispozicion Shtabit Operativ të UNÇ dhe të AP për Kosovë e Dukagjin.⁴

Brigada IV Sulmuese e Kosovës përbëhej nga pjesëtarët e shumë nacionaliteteve. Në mesin e tyre, pos shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve, kishte edhe italianë, rusë, kroatë dhe sllovenë.⁵

Sipas statutit të Brigadës, Shtabin e saj e përbënin: komandanti, komesari politik, zëvendëskomandanti, zëvendëskomesari politik dhe kryeshefi i shtabit.⁶ Në fillim Shtabi i Brigadës kishte këtë përbërje: Pavle Brajoviqi V komandant, Predrag Ajtiqi — komesar politik, Shaban Haxhija — kryeshef i Shtabit Janko Lakiçeviqi — zëvendëskomandant dhe Çedo Mijoviqi — zëvendëskomesar. Ndërsa në kuadrin komandues ishin edhe: Salko Myderrizi, Blazhdo Strugari — komandantë batalionesh, Dushan Shujica, zëvendëskomandant i Batalionit, Hysni Dobruna, Mate Furlah dhe Mehmet Maliqi V komandantë çetash, Ukë Gashi dhe Elhami Zeneli V komesarë politikë çetash etj. Pranë Shtabit të Brigadës ishte edhe toga e ndërldhjes e kavalerisë dhe e xhenjos.⁷

Në artikullin: »Është formuar Brigada IV Kosovare«, në gazetën »Liria« të nëntorit të vitit 1944, ndër të tjera thuhet: Brigada jonë IV ka rëndësi të madhe për LNÇ në Kosovë e Dukagjin. E përbërë prej djemve dhe vashave më të mira të shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve, ajo do të jetë shembull i vëllazërim-bashkimit të kombeve dhe të kombësive tona. Ajo është arma më e fortë kundër okupatorëve gjermanë e armiqtve të tjerë, dhe së bashku me Brigadën I Kosovare dhe Brigadën III dhe V të Shqipërisë duhet të luajë rol të rëndësishëm për çlirimin e popullit tonë dhe për krijimin e vëllazërimit dhe të bashkimit luftarak të popujve të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë.⁸

II. Organizimi ushtarak i Brigadës

Madhësia, përbërja si dhe armatimi i Brigadës ndryshonin varësisht nga kushtet në të cilat ajo vepronte. Në fillim Brigada kishte vetëm tri batalione. Batalionet ndaheshin në çeta, toga e dhjetëshe. Numri i çetave përcjellëse dhe i togave të mitralierëve varej nga numri i batalioneve të Brigadës.⁹ Në Brigadë, si në kuadrin e njësiteve përkatëse, ashtu edhe në terren vepronin edhe ekipet kulturore-arsimore.¹⁰

Marrëdhëniet ndërmjet kuadrin komandues dhe luftëtarëve ishin shoqërore dhe bazoheshin në vetëdijen dhe bindjen politike të çdo luftëtari.

⁴ Si shënimi, 1.

⁵ *Po aty*.

⁶ Si shën. 3.

⁷ Si shën. 1.

⁸ Mita Milkoviç, *Është formuar Brigada IV Kosovë e Metohisë*, »Liria«, nëntor, 1944.

⁹ Si shën. 3.

¹⁰ *Po aty*.

Mirëpo, sidoqoftë në Brigadën e posaformuar ndjehej mungesa e madhe e kuadrove të kombësisë shqiptare. Aq më tepër kur pas çlirimit të Gjakovës, për nevojat e Brigadës VII që po formohej, Ismet Shaqiri mori nga Batalioni I më se 30 luftëtarë dhe kuadro më të mira. Ndërsa Brigada V e UNÇ të Shqipërisë mori 16 luftëtarë për të plotësuar humbjet e saj, megjithëse numëronte shumë më tepër luftëtarë se Brigada IV.¹¹ Prandaj u ndërmorën masa që kuadri të krijohet nga efektivet e Brigadës. Kështu duke u mbështetur në forcat e brendshme, Brigada i hyri konsolidimit të vet pa u mbështetur aq shumë në ndihmën e të tjerëve.¹²

Në raportin e Shtabit Operativ të Kosovës të datës 17. XII. 1944 dërguar Shtabit kryesor të Serbisë, theksohej se Brigada IV Kosovare është ende e re dhe se po punohet në kompletimin dhe forcimin e saj organizativ dhe ushtarak. Në raport theksohej gjithashtu se kuadri komandues dhe luftëtarët e saj ende nuk ishin të ngritur sa duhet politikisht dhe ushtarakisht dhe se efektivet e saj nuk e kishin ushtruar sa duhet përdorimin e armëve, veçanërisht atyre të rënda. Kjo u vërejt gjatë aksioneve vendimtare kundër forcave vullnetare kur nuk mundën të përdoreshin sa duhet armët artilerike po edhe nëse u përdoren, efekti i tyre që fare i vogël.¹³

Më tej konstatohet se përkundër shpirtit luftarak të shumicës, te disa luftëtarë dhe kuadro udhëheqëse shfaqej frika nga vullnetarët, veçanërisht kur ata paraqiteshin në befasi dhe me grupe më të mëdha, anash ose prapa shpine, dhe kjo shkaktonte tërheqjen dhe ndonjëherë paniku përfshinte edhe pjesën më të vendosur të luftëtarëve.¹⁴ Mirëpo, pa marrë parasysh këtë më tutje në raport konstatohet me të drejtë se Brigada IV së bashku me njësitet e tjera të UNÇ të Kosovës është në gjendje t'ia dalë në krye me forcat vullnetare.¹⁵

Sipas vendimit të Shtabit Operativ të Kosovës, Brigada IV fillon çarmatimin e popullsisë. Mirëpo, kur merret parasysh sasia e armëve të dorëzuara, mund të thuhet se në këtë drejtim nuk u arrit sa duhet. Por megjithatë, ishte inkurajues fakti se shumica e luftëtarëve shqiptarë që hynin në Brigadë i sillnin më vete edhe armët dhe pajimet e tjera të nevojshme luftarake. Mobilizimi në fillim ishte vullnetar, ndërsa më vonë fillon edhe mobilizimi i përgjithshëm.¹⁶

Me riorganizimin e UNÇ të Kosovës, më 23. II. 1945, nga Brigada II dhe IV u formua Divizioni 52. Njëkohësisht u bë edhe riorganizimi i vetë Brigadës, të cilës iu shtua edhe një batalion. Kështu, edhe sa i përket organizimit të formacioneve ajo u nivelizua me shumicën e Brigadave të tjera në Kosovë. Disiplina ngritet në një nivel më të lartë edhe jeta partizane zëvendësohet me atë ushtarake.¹⁷ Mirëpo, megjithatë, gjendja ende nuk ishte stabilizuar sa duhet. Disiplina e jashtme ishte në nivel, ndërsa ajo e brendshme nuk kënaqte. Andaj edhe më tutje duhej të veprohej për

¹¹ KKKM, 289, nr. 1253, Raport i Çedo Mijoviqit.

¹² Po aty.

¹³ AIUH, K-1411, nr. 16-1/4.

¹⁴ AIUH, K-1411, nr. 1-3/5.

¹⁵ Si shën, 13.

¹⁶ AIUH, K-400, nr. 34/2p-6.

¹⁷ AIUH, K-1411, nr. 10-1/4.

ngritjen e vigjilencës revolucionare dhe besimit reciprok. Në mënyrë të veçantë luftoheshin dukuritë e shovinizmit dhe të qëndrimit përbuzës të disa individëve dhe eprorëve ndaj luftëtarëve shqiptarë.¹⁸

Shërbimi informativ i Brigadës, megjithë angazhimin maksimal, në fillim nuk ishte efikas në kryerjen e detyrave që parashtrheshin. Në shumë raste nuk u parapanë ose nuk u betuan synimet dhe manovrat e armikut si dhe dislokimi i forcave të tij. Shumë herë informatat vinin pasi fillonte sulmi i armikut ose pasi fillonte tërheqja e tij. Me fjalë të tjera, raportet arrinin atëherë kur efekti i tyre nuk mund të ndihej fare. Ky ishte shkak që udhëheqësve të Brigadës dhe të njësitëve të saj u mungonin iniciativa dhe vendosmëria për punë të pavarur, në mënyrë që në çdo situatë të sillin vendime të qëlluara.¹⁹

Shërbimi sanitar ishte mjaft i dobët. Në tërë Krahinën kishte vetëm një spital ushtarak në Prizren me 200 shtrretër, ndërsa organizimi i këtij shërbimi në qendrat dhe njësitet e tjerë ushtarak ishte ende në fillim. Materiali sanitar në Brigadë nuk mungonte aq shumë, por distribuimi dhe shpërndarja e tij nuk bëhej si duhet dhe shpesh nuk gjendej atje ku ishte nevoja. Megjithatë, shërbimi u përpoq maksimalisht dhe arriti të lokalizojë edhe epideminë e tifos së morrūt që u paraqit në Brigadë në pranverën e vitit 1945.²⁰

Furnizimi me ushqim dhe veshmbathje bëhej nëpërmjet organeve të prapavijës, këshillave nacionalçlirimtare dhe komandave të vendit. Përnga sasia ushqimi i plotësonte deri-diku nevojat, mirëpo ishte i njëllajt dhe mjaft i dobët përkah cilësia. Veshmbathja nuk i plotësonte as nevojat më elementare. Për shkak të laramanisë së veshmbathjes, nuk ishte e mundshme të vendosej disiplina ushtarake dhe kontrolli i duhur, ngase njësitet e Brigadës dalloheshin shumë pak prej së largu nga formacionet vullnetare.²¹

Problem më vete paraqiste dezertimi i luftëtarëve nga kjo Brigadë. Në fillim dezertimi bëhej në baza individuale ose në grupe të vogla, mirëpo më vonë në mënyrë masive. Kështu, më 17 mars të vitit 1945 dezertoi pjesa më e madhe e luftëtarëve të Batalionit IV që ndodhej në Krushë të Madhe. Me këtë rast prej 630 luftëtarëve sa kishte ky Batalion, dezertuan 430, ndërsa luftëtarët që mbetën, për shkak të pasigurisë, u çarmatosën dhe u sollën në Prizren, më 21 mars, ku u demobilizuan dhe u vunë nën rojet ushtarake. Pjesa më e madhe e dezertorëve, iu bashkua grupeve vullnetare të Dem Ali Pozharit, Mehmet Agë Rashkocit dhe Mehmet Berishës.²²

Si duket, dezertimit i kontribuoi veçmas edhe propaganda armiqësore se gjoja të gjithë shqiptarët do të dërgoheshin në Frontin e Sremit, ndërsa luftëtarët serbë dhe malazezë do të mbeteshin në Kosovë. Mirëpo

¹⁸ AIUH, K-1412, nr. 5-1/1 (Divizioni 52 në fillim kishte 6908 luftëtarë, prej të cilëve 3894 shqiptarë. Ndërsa Brigada IV kishte 1321 luftëtarë me 990 pusnkë, 51 pushkomitralezë, dhe 9 minahedhës të rëndë. Ndërsa Batalioni I 257 luftëtarë me 224 pushkë, 21 pushkomitrolezë dhe 1 mitralez të rëndë. Batalioni II 6-9 luftëtarë, 356 pushkë, 10 pushkomitralezë, 3 mitralezë të rëndë dhe 1 minahedhës. Batalioni II 455 luftëtarë, 408 pushkë, 29 pushkomitralezë, 5 mitralezë të rëndë dhe 1 minahedhës).

¹⁹ AIUH, K-1411, nr. 16-1/4.

²⁰ Po aty.

²¹ AIUH, K-1412, nr. 8-8.

²² AIUH, K-1411, nr. 1-35.

shkaqet e një dukurie të tillë janë mjaft komplekse dhe duhet kërkuar në keqësimin e situatës nëpërmasa të gjera si dhe në pakënaqësinë që u shfaq në radhët e luftëtarëve për shkak të sjelljeve jokorrekte dhe sektare të disa kuadrove udhëheqëse dhe të elementëve të ndryshëm armiqësorë të infiltruar në radhët e Brigadës. Është mjaft indikativ fakti se Shtabi Kryesor i UNÇ dhe i AP për Kosovë e Metohi, në fillim të prillit 1945, urdhëroi Brigadën që t'i ndalonte rreptësisht pushkatimet nëpër fshatra pa lejen e tij, duke kërkuar njëkohësisht raporte të hollësishme dhe të sakëta për njerëzit e pushkatuar në këtë mënyrë.²³

Në të njëjtën kohë u kërkua nga të gjithat formacionet e armatosura, pra edhe nga kjo Brigadë, që të mos hiqnin flamurin shqiptar të ngritur nga qytetarët e kësaj kombësie.²⁴

Organet kompetente ndërmorën të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e organizatorëve të këtij dezertimi masiv, i cili pati pasoja të rënda për Brigadën.²⁵ Mirëpo, në angazhimin e gjithanshëm të kuadrit udhëheqës dhe të organizatës partiake, kriza e shkaktuar nga dezertimi i përmendur u tejkalua me mobilizimin e më se 400 luftëtarëve të rinj, më 25 mars të vitit 1945, me ç'rast ajo i plotësoi efektivat e Batalionit IV të shpartalluar. Kështu, Brigada pati mundësi që nga efektivet e veta të ndajë 200 luftëtarë për nevojat e mbrojtjes popullore në Tetovë, ndërsa 75 të tjerë t'i dërgojë në kursin për shofer në Shkup.²⁶

Riorganizimi i Shtabit të Brigadës dhe i njësiteve të saj, që u bë ndërkohë, ndikoi dukshëm në forcimin e disiplinës dhe të mobilitetit në Brigadë. Mirëpo, nga ana tjetër, koordinimi i aktivitetit të Brigadës me komandat e vendit, si dhe funksionimi i tyre nganjëherë nuk zhvillohej sipas platformës së miratuar. Kjo për shkak se kuadri i këtyre komandave ende nuk kishte përvojë të nevojshme dhe shpesh i tejkalonte kompetencat e veta. Nga ana tjetër, këto komanda nuk bashkëpunonin sa duhet as me KNÇ dhe formacionet ushtarake në kalim. Prandaj Këshilli Krahinor Nacionalçlirimtar intervenoi shumë herë te Shtabi Operativ në mënyrë që të mënjanoheshin sjelljet arbitrare të këtyre komandave dhe të koordinojë më mirë bashkëpunimi me njësitet ushtarake, dhe që këto t'i përfillnin më tepër Këshillat Nacionalçlirimtare, si organe të pushtetit të ri popullor.²⁷

Për konsolidimin e radhëve të Brigadës dhe për ngritjen profesionale ushtarake të kuadrit të saj dhe të njësiteve të tjera, Shtabi Kryesor i UNÇ të Kosovës organizoi kurse për ushtarë dhe eprorë të çetave, batalioneve dhe brigadave. Kurse të ngjashme u organizuan edhe për udhëheqës të xhenjes dhe për lidhje. Për këto kurse u zgjodhën aktivistët dhe luftëtarët më të aftë e me perspektivë zhvillimi dhe përparimi, pa marrë parasysh gradën dhe pozitat momentale. Qëllimi i këtyre kurseve ishte aftësimi profesional i kuadrove për detyrat e ardhshme në njësitet përkatëse të organizuara në mënyrë bashkëkohore dhe të armatosura me armë më moderne. Pas kryerjes së këtyre kurseve, të gjithë pjesëmarrësit u kthyen në njësitet e veta të mëparme.²⁸

²³ AIUH, K-1412, nr. 1-1.

²⁴ AIUH, K-1411, nr. 3-2/6.

²⁵ AIUH, K-1411, nr. 40-1/5.

²⁶ AIUH, K-1411, nr. 4/15.

²⁷ AIUH K-1411, nr. 4/15.

²⁸ AIUH, K-1412, nr. 12-5/2.

III. Puna e Organizatës partiake

Organizata partiake e kësaj Brigade luajti rol të rëndësishëm në punën organizative politike, propogandistike dhe edukative të luftëtarëve dhe të kuadrove udhëheqëse. Lidhjet e Organizatës partiake me Shtabin e Brigadës i mbante komesari politik, që ishte delegat i Partisë në ushtri. Kurse në organizatën partiake udhëhiqte zëvendëskomesari. Zëvendëskomesarë politikë kishte edhe nëpër çeta (sekretarë të celulave) dhe batalione (sekretarë të byrove partiake të batalioneve). Roli i tyre, si punëtorë politikë, u foroua edhe më shumë kur u shpallën ndihmës të komesarëve politikë për punë partiake nëpër njësitet e veta.²⁹

Menjëherë pas formimit të Brigadës, më 14. X. 1944, u organizua këshillimi i udhëheqjes politike dhe i kuadrit komandues të Brigadës I dhe IV, në të cilën u analizua situata politike dhe ushtarake në Kosovë. Këshillimi, pos të tjerash, në fund konstatoi se u luhatën dukshëm pozitat e bashkëpunëtorëve të okupatorit nga goditjet e brigadave kosovare dhe UNÇ të Shqipërisë, që në atë kohë operonin në Kosovë. Dhe me këtë dështoi propaganda e armiqve se gjoja LNÇ në Kosovë e bëjnë vetëm serbët dhe malazezët.

Mirëpo, megjithatë, konkluzionet përkitazi me orientimin e masave ishin jo të sakëta dhe tejet subjektive. Kështu, për masat shqiptare thuhej se në pjesën më të madhe qenë të mobilizuara nëpër njësitet e ndryshme të okupatorit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, ndërsa për ato serbe dhe malazeze se gjoja qëndronin fuqishëm në pozitat e LNÇ.³⁰

Konkluzat e këshillimit të lartpërmendur u përpunuan në të gjitha batalionet dhe në Shtabin e Brigadës, me theks të veçantë në problemet me të cilat ballafaqohej Brigada në hapat e saj të parë.³¹

Pas tërheqjes nga sektori i Junikut, ku Brigada pati humbje të mëdha, u bë takimi i përbashkët i Shtabit dhe i Komitetit të Brigadës me temën: »Përvojat nga lufta në Gjakovë dhe Junik«, me ç'rast u analizuan rrethanat dhe faktorët që ndikuan në mossuksesin e kësaj ndërmarjeje. Me këtë rast u konstatuan një varg dobësish të natyrës objektive e subjektive.³² Në këtë mbledhje u fol edhe për djegien e 18 shtëpive nga të cilat supozohej se u është bërë rezistencë forcave të Brigadës. Ky akt u vlerësua si i dëmshëm dhe oportunist politik, që do të duhej të aplikohej vetëm në rastet e jashtëzakonshme, përkatësisht atje ku e kërkon dhe e miraton vetë populli. Në mbledhje u konstatua se qëndrimi i miratuar që armiqve të dalluar t'u digjeshin shtëpitë, ishte kuptuar bukvalisht nga disa eprorë dhe luftëtarë të kësaj Brigade. Dhe si rrjedhim dë-

²⁹ Si shën, 3: AIUH, Zbornik, tom. IX. knj. 7, dok. nr. 78. (Në ditën e formimit të Brigadës organizata partiake kishte 64 anëtarë, të cilëve iu bashkua edhe një nga Gjakova, ndërsa 10 të tjerë u pranuan rishtazi. Kështu, numri i përgjithshëm arriti në 75 veta. Mirëpo, që në ditët e para u vranë dy komunistë, ndërsa 5 të tjerë nuk gjendeshin në efektivat e Brigadës, kështu që numri i anëtarëve të Partisë mbeti 68).

³⁰ Këshillimi i udhëheqjes partiake të Brigadës I dhe IV. Kosovare, i organizuar më 14. X. 1944.

³¹ Si shën. 11.

³² Po aty.

nimin e armikut e shprehnin vetëm nëpërmjet djegies së shtëpive, duke shpallur çdonjërin si armik — të dalluar të popullit.³³

Më 23 tetor të vitit 1944 arritën konkluzionet me shkrim të këshillimit të 14. X. 1944. Po atë ditë u bë takimi i Komitetit të Brigadës, në të cilën u diskutua për përpunimin e Konkluzioneve nëpër Byrotë e Brigadës dhe u vendos që vërejtjet e rëndësishme të formulohen me shkrim dhe t'u dërgohen organeve përkatëse partiake dhe ushtarake. Dy ditë më vonë u bë mbledhja e celulës së Shtabit, ku, pos të tjerash, u analizuan detyrat më aktuale që shtroheshin në punën e organizatës partiake. Edhe celulat partiake bën mbledhjet e tyre me të cilat, pos përpunimit të materialeve të përmendura, qëndrimeve politike të Komitetit të Brigadës, diskutuan edhe për problemet e tyre të veçanta.³⁴

Organizata partiake u obligua që të angazhohet për ngritjen e nivelit luftarak, ideologjik e moral të efektiveve të Brigadës, e në mënyrë të veçantë të anëtarëve të saj. Po ashtu u angazhua për flakjen e qëndrimeve sektare ndaj masave shqiptare, si dhe për pranimin e anëtarëve në Parti nga radhët e kësaj kombësie. U kritikuan edhe pikëpamjet dhe konceptet burokratike që kishin filluar të depërtonin së bashku me ambiciet jo të shëndosha të disave që ankoheshin vazhdimisht se gjoja janë lënë anash dhe se nuk u janë njohur meritat etj. Kujdes i veçantë iu kushtua studimit dhe përpunimit të çështjes nacionale, për të cilën gjë u kërkua që materiali të sigurohet në të dy gjuhët.³⁵

Organizata partiake u zotua që në të ardhmen t'i ndihmojë më shumë Komitetit të BRKJ-it dhe Bashkimit të Rinisë Antifashiste të Brigadës. Kjo ndihmë ishte e nevojshme në kohën kur po bëheshin përgatitjet për mbajtjen e Konferencës I Krahinore të BRKJ-së. Kjo kishte një rëndësi të posaçme kur dihet se punës së BRKJ-it nuk i ishte kushtuar vëmendje e duhur.³⁶

Vlen të theksohet se në raportet e Çedo Mijoviqit, zëvendëskomisar politik i Brigadës, vërehen qëndrime sektare ndaj komunistëve të kombësisë shqiptare, të cilët i akuzon për »oportunizëm dhe rënie në pozitat e masave«.³⁷

Përkundër sakrificave dhe angazhimit maksimal, gjë që kjo Brigadë qe shpallur sulmuese, Mijoviq bën një varg vërejtjesh edhe për luftime që zhvilloi kjo Brigadë në Gjakovë dhe rrethinën e saj, duke e akuzuar për shumë dobësi objektive dhe subjektive. Edhe sa i përket bashkëpunimit me Brigadat e UNÇ të Shqipërisë ai bën një varg vërejtjesh, të cilat nuk përkrijnë me vlerësimet e qarqeve kompetente partiake dhe ushtarake lidhur me këtë bashkëpunim.³⁸

Sa i përket çështjes organizative mund të konkludohet se organizatat themelore partiake, celulat e Brigadës, nuk kanë bërë jetë normale partiake. Organizata nuk kishte plan pune dhe për ndarjen e detyrave dhe kjo ndikonte dukshëm në aktivitetin e anëtarëve të Partisë. Nga

³³ Si shën. 12.

³⁴ Si shën. 11.

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty.

ana tjetër ngritjes së anëtarëve nuk i kushtohej kujdes dhe rëndësi e duhur. E këtu ishte situata edhe në ngritjen profesionale e ushtarake të efektivëve, në përvetësimin e artit ushtarak. Mungonin ligjeratat profesionale, si dhe disa formave të tjera të ngritjes profesionale dhe ideo-politike. Karakteristikat për udhëheqësit partiakë jepeshin në mënyrë paushalle në kartotekën partiake, pa konstatuar gjendjen faktike. Nuk punohej sa duhej as në pranimin e anëtarëve të rinj. Megjithëse në Brigadë kishte mjaft asish që meritonin.³⁹

IV. BRKJ-së dhe Organizata e Rinisë Antifashiste

Meqë shumicën e luftëtarëve të Brigadës e përbënin të rinjtë, organizata e BRKJ-së dhe ajo e Bashkimit të Rinisë Antifashiste kanë qenë organizata politike më masive. Disiplina e anëtarëve të BRKJ-së ishte në nivel, meqë ata dalloheshin për kryerjen e detyrave të shumta që u parashtröheshin: marrëdhëniet ndërmjet të rinjve ishin të mira, ndërsa angazhimi dhe interesimi i tyre për kryerjen e detyrave ishte shembull për të gjithë luftëtarët. Megjithatë pati edhe raste kur u thyen rregulli dhe disiplina dhe kur kundër anëtarëve të tillë të BRKJ-së u morën masa të ashpra.⁴⁰

Aktiviteti propagandistik e politik zhvillohej aq sa rrethanat lejonin. Mirëpo në sektorin politik, kulturor e arsimor që arritur më shumë vetëm në zhdukjen e analfabetizmit, shkrimin e parullave dhe organizimin e vallëzimeve. Organizata e BRKJ-së angazhohej edhe për aftësimin e të rinjve në pikëpamje profesionale — ushtarake.⁴¹ Në sektorin teknik puna shkonte më vështirë, me që për një aktivitet të tillë nuk ekzistonin kushtet e nevojshme. Mirëpo, përkundër kësaj, u bënë një varg mbledhesh në të cilat u analizua aktiviteti i organizatës së rinisë në Brigadë. Organizata e BRKJ-së në terren, në fillim, nuk e kishte sa duhet iniciativën, megjithëse qëndrimi i anëtarëve të BRKJ-së ndaj popullit ishte i drejtë dhe konstruktiv.⁴²

Me gjithë angazhimin për tejkalimin e vështirësive organizative, organizata e rinisë vuante nga një varg dobësish. Kështu, detyrat nuk i kryente si duhet, anipse mundësitë ekzistonin. Indifrentizmi dhe neglizhenca ishin të pranishme sidomos në Batalionin II të kësaj Brigade. Kjo ndodh për shkak të ndërtimit të shpeshtë të udhëheqjeve të batalionit, çetave, togave dhe të dhjetësheve, dhe kjo pengonte mjaft pavarësimin dhe konsolidimin ushtarak dhe ngritjen ideo-politike.⁴³

Aktiviteti i BRKJ-së ishte mjaft i gjallë veçanërisht në kohën kur erdhi direktiva për përgatitjen e Konferencës së Parë të Rinisë Antifashiste të Kosovës. Lidhur me këtë çdo ditë bëheshin mbledhjet e çetave, të batalioneve, të BRKJ-së dhe të Rinisë Antifashiste.⁴⁴

³⁹ Si shën. 11.

⁴⁰ KKKM 298, nr. 320.

⁴¹ Raport 15-ditësh i Komitetit të BRKJ-së të Brigadës IV, dt. 15. XI. 1944.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ AIUH. Tom. IX, knj. nr. 7, d. nr. 78, fq. 405.

V. Rruga luftarake e Brigadës

Rruga luftarake e Brigadës IV ka qenë e vështirë dhe plot sakrificë. Ajo në bazë të planit të Shtabit Operativ të UNÇ dhe të APJ të Kosovës së bashku me Brigadën I Kosovare dhe me Brigadën III dhe V të Shqipërisë, mori për detyrë që të pengonte tërheqjen e forcave gjermane nga Shqipëria në drejtimet Shkodër—Prizren—Gjakovë—Pejë dhe Prizren—Ferizaj—Prishtinë si dhe të çlirojë Rrafshin e Dukagjinit, Aksionet luftarake së bashku me njësitet e përmendura Brigada i filloi në jug të Prizrenit dhe të Gjakovës për të vazhduar pastaj sulmin e përgjithshëm edhe për çlirimin e këtyre qendrave të rëndësishme strategjike.⁴⁵

Pas sulmit në Urën e Tërzive njësitet e Brigadës IV, me qëllim që të mashtronin armikun, kah dreka u tërhoqën në drejtim të Damjanit dhe të Pashtrikut. Ndërkohë, sipas urdhërit të Shtabit Operativ të UNÇ të Kosovës, njësitet e Brigadës IV Kosovare dhe të asaj të UNÇ të Shqipërisë filluan sulmin mbi qytet, të cilin e mbrojnë më se 200 gjermanë dhe 500 bashkëpunëtorë të tyre. Në të njëjtën kohë njësitet e Brigadës I Kosovare dhe të Brigadës III të UNÇ të Shqipërisë siguronin krahun në drejtimin Gjakovë—Pejë, kurse ato të Brigadës IV Kosovare dhe V të UNÇ të Shqipërisë mbrojnë krahët e forcave sulmuese për gjatë rrugës Gjakovë—Prizren—Pejë.⁴⁶

Pas luftimesh të rrepta u çlirua pjesa më e madhe e qytetit. Çeta e parë e Batalionit I, e komanduar nga Mehmet Maliqi, zbriti nga Çabrati në lumin Erenik dhe mori ndërtesën e xhandarmërisë, të bashkisë, shtëpinë e oficerëve dhe hotelin e vjetër.⁴⁷ Pjesa e çliuar e qytetit mbeti dy ditë në duart e forcave çlirimtare. Me këtë rast u bë kontrollimi sistematik dhe u zunë ose u dorëzuan më se 150 vullnetarë dhe bashkëpunëtorë të tjerë të okupatorit, Mirëpo, për shkak të kohës së shkurtër, shumë prej tyre nuk u kapën, edhe pse fshiheshin mu në sektorin të cilin e çliroi kjo Brigadë. Shpëtoi madje edhe vetë Beqir Maloku, Gjermanëve të barikaduar mirë së shpejti u erdhën në ndihmë forca të reja. Prandaj, për t'u ikur humbjeve të mëdha, forcat e Brigadës IV Kosovare dhe të njësiteve të tjera u tërhoqën 18. X. 1944, në drejtim të Qafës së Prushit, ku u ndalën për të pushuar. Gjatë kësaj tërheqje Brigada pati 5 të plagosur.⁴⁸

Kështu, me gjithë angazhimin e luftëtarëve të njësiteve të UNÇ nuk u arrit pikësynimi themelor: çlirimi dhe mbajtja e qytetit. Ndër faktorët që ndikuan në këtë drejtim përmenden, pos të tjerësh, forcat e pamjaftueshme ngase në këto luftime mori pjesë vetëm një batalion e gjysmë i Brigadës IV dhe një batalion i Brigadës III të UNÇ të Shqipërisë, në vend që të angazhoheshin tërësisht të dy batalionet e një të mbetej për sigurimin e prapavijës dhe të krahëve të sulmuesve. Pastaj ndikoi edhe mosshembja e Urës së Fshenjtë dhe koordinimi i pamjaftueshëm i aksioneve.⁴⁹

⁴⁵ AIUH, K-1412, nr. reg. 11-3.2.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ »Rilindja«, 18. X. 1979. Prishtinë.

⁴⁸ AIUH K-1412, nr. 5-4/2.

⁴⁹ KKKM. 289, nr. 1253.

Sulmi në Gjakovë dhe çlirimin e pjesës më të madhe të qytetit, si dhe parakalimi i partizanëve bën efekt të jashtëzakonshëm. Ky efekt do të ishte shumë më i madh sikur të çlirohej i tërë qyteti dhe të mbahej së paku disa ditë. Aq më tepër kur kjo ishte bërë imperative i kohës, meqë tash kishte filluar sulmi i përgjithshëm i njësiteve të UNÇ për çlirimin definitiv të kësaj treve.⁵⁰

Pas tërheqjes nga Gjakova, më 20. X. 1944, Brigada IV Kosovare së bashku me Brigadën II të UNÇ të Shqipërisë e sulmuan Junikun, por nuk arritën ta marrin, meqë armiku në fortifikata kishte përqëndruar forca bukur të mëdha. Më 22 tetor dy batalione të kësaj Brigade së bashku me Brigadën I bën edhe një sulm të përgjithshëm për çlirimin e këtij lokaliteti strategjik të fortifikuar mirë, të cilin e mbronin 400 gjermanë dhe 200 vullnetarë. Sulmi zgjati 10 orë, por forcat partizane nuk arritën të shpartallonin reaksionin në këtë sektor, megjithëse ishin numërikisht superiore.⁵¹ Nga ana tjetër, armiku me manovrim të luftonin larg komunikimeve dhe në terrenin që i përshtatej më shumë atij, atje ku ai kishte në situatë më të volitshme në një vend me kulla të larta e të mbrojtura nga muret e fortifikuara, në një rreth ku ndikimi i krerëve dhe i reaksionit ishte ende i pranishëm.⁵² Pas kësaj, armikut i erdhën forca të freskëta nga Peja dhe sulmi i vullnetarëve nga ana e Molliqit bëri që Brigada IV së bashku me njësitet e tjera të tërhiqen kah kufiri jugosllavo-shqiptar.⁵³ Në anën tjetër, për shkak të rritjes së nivelit të Drinit lidhjet e Brigadës me Prizrenin u ndërprejnë, ndërsa reaksioni në këtë qytet bënte arrestime dhe apelonte që familjet partizane t'i sillnin bijtë e tyre në shtëpi.⁵⁴

Vlenë të theksohet se gjatë këtyre operacioneve Brigada pati 35 të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa armiku 40 të vrarë dhe 25 të plagosur. Brigada u rrezikua veçanërisht për shkak të humbjeve në kuadrin komandues dhe partiak. Nga radhët e tyre u vranë Hysni Dobruna, Milan Nikoliqi etj, kurse prej 15 të plagosurëve 6 qenë anëtarë të Partisë si: Faik Pruthi, komesar i batalionit, Avdi Bakalli, komesari i çetës, Milan Mitrovici, zvendëskomandant batalioni, Mileta Peroviqi, komandir çete Savo Besoviqi, zvendëskomesar i çetës, Dana Malishiqi etj. U plagosën edhe 4 anëtarë të BRKJ-së.⁵⁵

Me qëllim që të pengoj tërheqja e njësiteve gjermane kah veriu nëpër Çakorr për në Mal të Zi e tutje, si dhe në drejtim të veri-lindjes nëpër Mitrovicë — Novi Pazar — Sjenicë — Kralëvë, Shtabi Operativ dha urdhër për rrënimin e urave dhe shkatërrimin e komunikacioneve në Rrafshin e Dugagjinit.⁵⁶ Pjesët e Brigadës IV, më 14. XI. 1944, në prag të çlirimit të Gjakovës, sulmuan mbrojtjen gjermane në Urën e Terzive (afër Gjakovës) dhe u përpoqën që ta shkatërronin me qëllim që të pengohej kalimi i kolonave gjermane që tërhiqeshin në drejtim të Pejës e të Ça-

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Si shën. 14.

⁵² Si shën. 13.

⁵³ Si shën. 19.

⁵⁴ KKKM, 301, nr. 323, letër e Jabllanit 30. X. 1944.

⁵⁵ KKKM, 303, nr. 325, Raport 15-ditësh për punën e organizatës partiake në Brigadën IV Kosovare.

⁵⁶ AIUH, K-1411. nr. 2-11/1.

korrit. Mirëpo, në këtë aksion nuk patën suksese për shkak të rezistencës së fuqishme të armikut. Ndërkohë, në sektorin e Drenicës, në fshatin Plloqicë, Batalioni I i Brigadës IV, nën komandën e Enver Dajçit, i shpartalloi forcat vullnetare, të cilat patën 20 të vrarë e shumë të plagosur, kurse partizanët patën 3 të vrarë dhe u plagosën gati të gjithë anëtarët e Shtabit të Batalionit në fjalë.⁵⁷ Vlen të theksohet se gjatë tërë ditës së 15 nëntorit të vitit 1944 aviacioni aleat bombardoi dhe mitraloi pozitat e armikut, duke i lehtësuar në këtë mënyrë Brigadës IV për shpartallimin e mbrojtjes gjermane dhe të vullnetarëve në Urën e Terzive, si dhe për dëmtimin e vetë urës.

Në këtë mënyrë, pas luftimeve gati njëmujshe kundër Grupit luftarak »Skenderbeg«, njësitet e Brigadës IV të Kosovës dhe të Brigadës V të UNÇ të Shqipërisë, me pjesëmarrjen aktive të popullsisë së qyteteve dhe të rrethinës, më 9. XI. 1944 e çliruan Gjakovën.⁵⁸

Përkitazi me zhvillimin e suksesshëm të LNÇ gjatë kësaj kohe, komanda e Brigadës IV e Kosovës kërkon nga Komiteti Krahinor sqarimin rreth statutit të ardhshëm të Kosovës. Ky shpjegim nevojitej për hartimin më të konkretizuar të proklamatës së 7 nëntorit.⁵⁹

Tërheqja e pjesës kryesore të Grupit të armatave »E« nëpër Kosovë kah mesi i nëntorit të vitit 1944 kishte hyrë në fazën përfundimtare. Mirëpo, për shkak të veprimit të Brigadës I dhe IV të Kosovës, si dhe të Brigadës III dhe V të Shqipërisë, ky Grup nuk arriti të depërtonte nëpërmjet Çakorrit në Mal të Zi, prandaj u detyrua të kthehej në drejtim të Mitrovicës dhe luginës së Ibrit dhe kjo shkaktoi tollovi të mëdha në radhët e bashkëpunëtorëve gjermanë dhe të forcave vullnetare. Në këtë situatë njësitet e Brigadës V të UNÇ të Shqipërisë dhe Brigadës IV të Kosovës, më 17. XI. 1944, hynë në Prizren, kurse të nesërmen çliruan Rahovecin, pastaj Suharekën dhe Podrimën, duke depërtuar kështu në drejtim të Drenicës dhe të Fushë-Kosovës.⁶⁰ Ky marshim zgjati prej 21 deri më 26. XI. 1944, kur Brigada prej Rahoveci arriti në Prishtinë, dhe brenda 4 ditësh vendosi rendin dhe qetësinë në qytet dhe rrethinë. Më 31. XI. Brigada niset për në Gjilan, ku qëndron 15 ditë. Gjatë kësaj kohe arriti të mobilizojë 600 luftëtarë të rinj e të spastrojë qytetin me rrethinë nga forcat vullnetare.⁶¹

Pas qëndrimit në Gjilan, më 18. XII. 1944, Brigada u nis në drejtim të Pejës, duke spastruar terrenin gjatë rrugës. Në Pejë ajo zuri edhe Xhevat Begollin me një grup prej 10 vetesh, të cilët më vonë u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan. Me këtë rast u vra edhe shefi i Gestaposë së Pejës, shërbëtori i urreyer i okupatorit, Sefa i Najës.⁶²

Shtabi Operativ i UNÇ dhe i AP të Kosovës, më 20. XII. 1944, urdhëroi që Brigada IV e Kosovës të vepronte në sektorin në mes të Drinit të Bardhë dhe Bisticës së Deçanit, të aftësonte hekurudhën dhe rrjetin telefonik përgjatë saj. Njëkohësisht, pjesëve të kësaj Brigade iu

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ AIUH K-234, nr. 15-17/1. 60 Fadil Hoxha, *Betejat përfundimtare për çlirimin e Kosovës*, Kosova IV, fq. 13, Prishtinë 1975.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ AIUH K-234, nr. 15-224.

⁶² AIUH K-1412, nr. 5-4/2.

urdhërua që të organizojnë efektivet ndjekëse për spastrimin e terrenit.⁶³ Mirëpo, sipas porosive të Shtabit Operativ, gjatë këtyre aksioneve nuk do të duhej të zvogëlohej aftësia mbrojtëse e garnizoneve dhe e komandave të vendit, edhe pse për mbulimin e territorit përkatës kërkoheshin forca të konsiderueshme që duhej të ndaheshin nga institucionet e përmendura. Në të njëjtën kohë, për kryerjen më të suksesshme të kësaj detyre nga njësitet e Brigadës, u kërkua që të shfrytëzojnë taktikën e pasur të luftës guerile dhe antiguerile, duke kontrolluar, duke izoluar fshatrat që u ofronin ndihmë grupeve vullnetare. Mirëpo, në të njëjtën kohë shtabet përkatëse këshilloheshin që efektivet e veta të mos i angazhonin përtej mundësive të kondicionit fizik. Ndërsa, përkitazi me qëndrimin ndaj armikut, kërkoheshin që kundër tij të luftohet në mënyrën më të ashpër dhe pa kurrfarë mëshire. Ndaj fshatarëve që rezistonin ose u jepnin ndihmë vullnetarëve të ndërmerreshin masa represive, në mënyrë që ata ta ndjenin forcën e armës partizane.⁶⁴ Në urdhërin e përmendur kërkohet që njësitet e kësaj Brigade të paraqesin në mënyrë të denjë fytyrën e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke bërë dallim ndërmjet kriminelëve dhe njerëzve të ndershëm. Të ndershmit thuhej të thërriten në njësite me armë, ndërsa ata që nuk duan të mbesin në Brigadë të çarmatosen, meqë armatimi i njësiteve të Brigadës kishte një rëndësi të jashtëzakonshme.⁶⁵

Më 7 janar të vitit 1945 Brigada u nis në drejtim të Drenicës për të shpartalluar rezistencën e përgjithshme të forcave vullnetare. Më 29 janar të vitit 1945 Shtabi Operativ i UNÇ dhe i AP të Kosovës urdhëroi rrethimin dhe shpartallimin e pjesës kryesore të këtyre forcave që udhëhiqeshin nga Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica. Brigada IV mori për detyrë që me dy batalione të veprojnë në drejtim të Tërstenikut dhe të Polluzhës, ndërsa batalionet e tjera në bashkëveprim me njësitet e Brigadës I të veprojnë në sektorin e Obrisë së Epërme dhe të Poshtme që të mos e lejonin armikun që të hudhej në drejtim të Perëndimit. Pas luftimesh të ashpëra pesëditëshe, armiku u tërhoq duke lënë në terren shumë të vrarë e të plagosur. Mirëpo edhe Brigada pati 50 të vrarë dhe 15 të plagosur.⁶⁶

Pas kësaj Brigada IV vepronte në sektorin e Kotës 612, përkatësisht në veri dhe në perëndim të fshatit Dashevc deri te Kota 745. Shtabi të Brigadës iu urdhërua të qëndronte në front për të udhëhequr drejtëpërdrejt me operacionet, duke pasur në këtë mënyrë kontrollin mbi njësitet e veta.⁶⁷

Në situatën e rikrijuar, pas sukseseve të para kundër forcave vullnetare, Shtabi Operativ urdhëroi që njësitet e Brigadës IV të Kosovës, nëpër kreshtat e Çyçavicës të dalin në Lipovicë e pastaj të kthehen kah perëndimi e të nisen në drejtim të Pejës. Njëkohësisht, kjo Brigadë mori për detyrë që me një batalion të vetin të zëvendësojë njësitet e Brigadës VI Malazeze të dislokuara në këtë vend.⁶⁸

⁶³ Zbornik Tom. I knj. 19. dok. nr. 213.

⁶⁴ AIUH, K-1308, nr. 18-4/1: Zbornik Tom, I Knj. 19. nr. 212.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ AIUH K-1411, nr. 6-1/4, 6-2/4, 7-4.

⁶⁷ AIUH K-1411, nr. 10-1/4.

⁶⁸ »Kosova«, nr. 4. fq. 75. Prishtinë 1975.

Gjatë këtij marshimi pjesët e Brigadës IV të Kosovës, më 8. V. 1945, sulmuan forcat vullnetare në fshatrat Ticë dhe në Obri të Poshtme, dhe pas pesë ditë luftimesh i dëbuan nga ky sektor duke u shkaktuar humbje të ndjeshme, si në njerëz, ashtu edhe në material luftime. Në të njëjtën kohë njësitet e kësaj Brigade së bashku me pjesët e Divizionit 24 dhe të Korpusit të Mbrojtjes Popullore bënë spastrimin e terrenit nga çetnikët dhe vullnetarët në vijën Prekocv — Glladno Sello dhe i shpartalluan forcat armike që kishin zënë pozicionet në shpatet perëndimore dhe nëpër kreshtat e Çyçavicës. Luftime të ashpëra u zhvilluan edhe në fshatin Rezallë, më 12. II. 1945, me ç'rast njësitet e kësaj Brigade i shkaktuan armikut humbje të mëdha.⁶⁹ Ndërsa, më 14. II. Brigada IV së bashku me njësitet e Divizionit 24 e sulmuan armikun në fshatrat Kozhiccë dhe Zhegovc, duke e shpartalluar plotësisht. Në këto luftime u inkuedruan dhe Brigada V e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë.⁷⁰ Një ditë më vonë efektivet e Brigadës IV të Kosovës u ndeshën në forcat e Shaban Polluzhës në Çyçavicë dhe fshatin Gradicë, mirëpo pas dy ditë luftimesh armiku ia arriti të çajë rrethimin, duke lënë 25 të vrarë dhe sasi të konsiderueshme materiali luftarak. Brigada IV pati 10 të vrarë dhe 7 të plagosur.⁷¹

Luftimet vendimtare me forcat e Shaban Polluzhës dhe të Mehmet Gradicës u zhvilluan më 21 dhe më 22 shkurt të vitit 1945. Në fillim njësitet e Brigadës IV i rrethuan këto forca dhe i bombarduan me artilleri, por pa ndonjë efekt të veçantë ngase mungonte kuadri i nevojshëm dhe njerëzit e aftë për këtë. Që në fillim u plagos Shaban Polluzha, ndërsa dy përcjellësit e tij u vranë. Në orën 17 u bë sulmi vendimtar dhe depërtimi në tri shtëpitë prej nga bëhej rezistencë. Ndërkohë forcat e Shaban Polluzhës bënë kundërsulm dhe u çanë rrethimin në drejtim të fshatit Gollubovc. Gjatë kësaj përpjekje u vranë 19 vullnetarë dhe u plagosën shumë të tjerë. Me këtë rast u plagos për të dytën herë Shaban Polluzha dhe po atë natë vdiq në malin afër fshatit Çikatovë. U plagos edhe Mehmet Gradica, ndërsa i biri i Shaban Polluzhës, Tafa, u vra dhe kufoma e tij u gjet të nesërmen. Në këtë mënyrë armikut iu shkaktuan humbje të konsiderueshme ngase u vranë ose u plagosën më se 50 vetë, ndër ta edhe udhëheqësit më të dalluar.⁷²

Vlen të përmendet se gjatë shpërthimit të rrethimit të vullnetarëve, Batalioni III nuk u angazhua sa duhet, kurse Batalioni IV as që reagoj fare, por u la vullnetarëve kalim të lirë. Shkaqet e një dukurie të tillë nuk janë vërtetuar saktësisht. Nuk dihet nëse kjo ndodhi për shkak të moskujdesit apo sabotimit të eprorëve të batalionit në fjalë.⁷³

Pas këtyre operacioneve, më 23. II. 1955, Brigada IV në përbërje të Divizionit 52 të UNÇ të Kosovës u dislokua në sektorin e Çyçavicës dhe fshatrat rrëzë saj, duke përfshirë nga ana perëndimore sektorin në vijën Lladrovç-Açarevë-Murgë-Gollubar-Zhegovç-Rruga: Prishtinë-Rahovec-Korreticë-Gillogovc-Kamenicë-Dabishevç-Llauhë.⁷⁴

⁶⁹ AIUH, K-1412, nr. 5-4/2.

⁷⁰ AIUH, K-1411, nr. 12-6.

⁷¹ Si shën. 60.

⁷² AIUH, K-1411, nr. 2-2/5, 2-5/5, 9-1/5, 10-5, 11-1-5, 11-2/5.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ AIUH, K-1412, nr. 4-1/2.

Mund të konkludohet se luftimet që zhvilluan efektivet e Brigadës IV së bashku me njësitet e tjera të UNÇ dhe të AP të Kosovës në bashkëpunim me njësitet e UNÇ të Shqipërisë dhe të Serbisë, qenë të suksesshme ngase armiku u shpartallua gati plotësisht. Mbeturinat e tij, të dërmuara, të ndara në grupe të vogla dhe të izoluar, fshiheshin nga njësitet e UNÇ, duke mos qenë në gjendje të pranonin luftën si dikur. Në radhët e tyre ende gjendej Mehmet Gradica i plagosur.

Pas këtyre ngjarjeve Brigada IV e Kosovës u dislokua në sektorin në mes të fshatrave Llaushë-Turiçevc-Sllatinë-Grabovcë-Kreshtat e Çyçavicës e deri në fshatin Drenovc.⁷⁵

Batalionet e Brigadës IV u vendosën në pikat prej nga më së mirë mund të bëhej kontrollimi dhe bllokimi i sektorit të përmendur. Me një shpërndarje të këtyllë më lehtë mund të kryeheshin detyrat taktiko-ushtarake dhe të punohej në ngritjen ideopolitike si dhe në kalitjen luftarake të efektiveve të Brigadës. Në të njëjtën kohë u organizuan reparte të vogla vëzhguese, të cilat qëndronin gjithnjë në terren. Taktika e këtyllë u tregua e përshtatshme meqë tash nuk ishte e nevojshme të ndaheshin forcat e mëdha për ndjekjen e grupeve të vogla të vullnetarëve. Nga ana tjetër, shërbimi informativ i Brigadës u angazhua që të zbulojë Mehmet Gradicën dhe të plagosurit e tjerë, si dhe vullnetarët e prijësit e tyre që ende fshifeshin në fshatrat e afërme. Gjithashtu, një kujdes i veçantë i kushtua identifikimit të kufomës së Shaban Polluzhës.⁷⁶

Pas shpartallimit të grupeve kryesore vullnetare gjendja në këto anë fillon të stabilizohet. Ndërkohë, Divizioni 52 mori për detyrë që të mbulojë sektorin Prizren-Rahovec-Shtimje dhe të vazhdojë spastrimin e pjesëve malore të tij, ku supozohej se ende ndodheshin grupe të vogla vullnetarësh. Sektori i përmendur u nda asisoji ndërmjet Brigadës IV dhe brigadave të tjera që as një pjesë e tij nuk mbeti jashtë kontrollit të këtyre forcave. Në bazë të kësaj ndarje, Brigadës IV iu caktua të mbrojtë Rahovecin me rrethinë. Gjatë qëndrimit në këtë sektor, më 7 mars 1945, Brigadës iu dorëzuan 46 vullnetarë, kurse të nesërmen edhe 30 të tjerë.⁷⁷

Pas kryerjes së këtyre operacioneve Shtabi i Divizionit 52 urdhëroi Brigadën IV që një batalion i saj të bëjë spastrimin e terrenit në Malin Kodra dhe në malet e Drenicës, si dhe në fshatrat përreth, për të dalë në vijën Shtrubullojë-Nekovc. Batalioni tjetër të vazhdojë këtë aksion nga sektori i Pustosellës dhe Ostrozubit e deri në hekurudhë. Ndërsa dy batalione të tjera të mbetën në pozitat e mëparme.⁷⁸ Më vonë Brigada i dislikoi batalionet e veta si vijon: Batalioni I në sektorin Prizren-Zhur, Batalioni II në sektorin Shtimje-Suharekë, kurse Batalioni III në sektorin Rahovec me rrethinë.⁷⁹ Edhe kësaj radhe efektivet e Brigadës IV duhej të bënin spastrimin e terrenit nga grupet vullnetare njëjft të lëvizshme, të cilave u qenë bashkuar edhe dezertorët e Batalionit IV. Njëkohësisht, Brigada u angazhua për konsolidimin e pushtetit të ri popullor në këto anë.⁸⁰

⁷⁵ AIUH, K-1412, nr. 4-1.

⁷⁶ *Po aty.*

⁷⁷ AIUH, K-1412, nr. 5-4/2.

⁷⁸ AIUH, K-1411, nr. 26-4.

⁷⁹ AIUH, K-1412, nr. 2-6/7.

⁸⁰ *Po aty.*

Më 19. III. 1945, Brigada IV kaloi prej sektorit të Prizrenit në rrethinën e Ferizajit, duke vendosur dy batalione në sektorin Shtimje-Magurë dhe së bashku me Brigadën V të UNÇ të Shqipërisë formoi një vijë fronti deri në Godenë. Të nesërmen dy batalione të saj dhe dy batalione të Brigadës I filluan spastrimin e terrenit në sektorin e Zhegovcit.⁸¹

Në sektorin e Zhegovcit dhe të Karadakut gjendeshin grupe mjaft të mëdha vullnetarësh nën udhëheqjen e Bajrush Kapetanit (Ali Stanovcit). Për shpartallimin e tyre u dërguan dy batalione të Brigadës IV, të cilat zhvilluan operacione në sektorin Karadak-Kopilaçë.⁸² Mirëpo, gjatë këtyre operacioneve si pasojë e manovrimeve të ngathta, lidhjeve dhe koordinimeve të dobëta ndërmjet njësiteve në terren, si dhe shfrytëzimit joracional të mjeteve të ndërlidhjes, njësitet e kësaj Brigade nuk treguan efikasitet të duhur. Në anën tjetër as Shërbimi i zbulimit dhe ai Informativ nuk qenë në nivelin e duhur. Ndërsa kuadri komandues nuk qe në gjendje të udhëheqë si duhet me njësitet e veta, duke mos shfrytëzuar sa duhet terrenin e përshtatshëm dhe superioritetin e efektivave të veta.⁸³

Pasi nuk arritën të çajnë rrethimin, natën në mes të 13 e 14 prillit në sektorin e Brigadës IV, që shtrihej prej Kotës 758 në jug — perëndim të Babushit serb e deri në rrugën Ferizaj-Shtimje-Jezercë, forcat vullnetare u tërhoqën në drejtim të malit Zhegovc dhe prej andej u hodhën në Kopilaq.⁸⁴

Në gjysmën e dytë të prillit Brigada gjendej në territorin e Maqedonisë, në fshatin Bogdanci, me ç'rast dezertuan 30 luftëtarë të saj, ndërsa në veri të Demir Kapisë, ajo u sulmua nga forcat çetnike. Më 20 prill Brigada e lëshoi terrenin e Demir Kapisë dhe u nis për në Gradsko. Më 22 prill arriti në Veles. Të nesërmen ajo së bashku me Shtabin e Divizionit 52 u nisën me tren për në Gornje-Lisë, ku qëndruan dy ditë, e pastaj u nisën në drejtim të Bujanovcit dhe pas dy ditësh kaloi në sektorin Kamenicë-Hajnovc-Vaganesh. Prej këndej pjesët e Brigadës IV dhe I vazhduan spastrimin e terrenit Negovc-Mali i Lipovicës, ku u ndeshën me një grup prej 8 vullnetarësh. Në këtë përleshje Brigada pati 3 të vvarë dhe 2 të plagosur, ndërsa armiku pati 1 të plagosur.⁸⁵

Ndërkohë, ngritja ideopolitike dhe stërvitjet ushtarake zhvilloheshin në kufijtë e mundësive ekzistuese.⁸⁶ Theksohej dhe shpjegohej veçmas situata në Kosovë si dhe mënyra e sjelljes ndaj popullsisë, përqëndrimi i diferencuar ndaj vullnetarëve dhe ndaj atyre që zihen ose dorëzohen me armë ose pa to.⁸⁷

Më 30 prill të këtij viti nga sektori Hajnovc-Kamenicë-Vaganesh, Brigada u nis për në sektorin Podujevë-Orllan. Gjatë këtij marshimi puna politike dhe aktivitet e tjera shoqërore nuk mund të zhvilloheshin në ni-

⁸¹ Po aty.

⁸² AIUH, K-1411, nr. 4-/15. (Gjatë kësaj kohe nuk pati ndryshime të mëdha në sektorin operativ të këtij njësi. Ndërsa dezertorët e Batalionit IV gjendeshin në sektorin Damjan — Zymë. Ata ishin të ndarë në grupe të vogla dhe fshifeshin nga njësitet e UNÇ duke lëvizur prej një vendi në vendin tjetër).

⁸³ AIUH, K-1411, nr. 4/15.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ AIUH, K-1411, nr. 3-2/6.

⁸⁶ AIUH, K-1412, nr. 5-5/2.

⁸⁷ Si shën. 85.

velin e kërkuar. Më 5 maj Brigada u vendos në Podujevë dhe rrethinën e saj. Edhe në këtë sektor ajo duhej të luftonte kundër grupeve vullnetare dhe të ndihmonte konsolidimin e pushtetit të ri popullor.⁸⁸

Pas kryerjes së këtyre aksioneve, Brigada u nis në drejtim të Kollashinit të Epërm dhe malit Rogozna, në veriperëndim të Mitrovicës. Një batalion u dislokua në sektorin Kotor-Radishevë, tjetri në rrethinën e Crepullës, një në Gazivodë-Pridvoricë dhe tjetri në sektorin Padine-Banjëskë. Selia e Shtabit të Brigadës ishte në Pridvoricë.⁸⁹

Aktivitetin e Brigadës e vështirësonte fakti se te një pjesë e popullsisë së kësaj ane ende ndihej ndikimi i grupeve çetnike, që ende kishin mbështetje në disa fshatra të izoluara. Po ashtu ndihej edhe ndikimi i reaktionit shqiptar.⁹⁰

Duke qenë një kohë të gjatë nën presionin e vazhdueshëm të reaktionit, popullsia e kësaj ane nuk kishte qëndrim siç e kërkonte situata dhe orientim të drejtë. Mirëpo, është interesant të theksohet se popullsia shqiptare e kësaj treve ishte më e orientuar kah LNÇ se sa ajo serbe.⁹¹

Gjatë kësaj kohe morali i luftëtarëve të Brigadës dhe shpirti luftarak ishin ngritur në nivel të nevojshëm. Ishte vendosur disiplina dhe rregulli. Edhe përgatitja dhe aftësia luftarake ishin në nivel. Mirëpo, lidhjet ndërmjet njërive të Brigadës në front ishin mjaft të vështirësuar dhe kryeshin vetëm nëpërmjet të korrierëve. Në këtë drejtim efekt të posaçëm pati vendosja e lidhjes telefonike me Shtabin Operativ.⁹²

Me këtë sektor Brigada u ndesh disa herë me forcat e izoluara vullnetare dhe ato çetnike. Kështu, më 7 maj 1945 në bjeshkët e Vojdullit, njësitet e saj u përleshën me grupin e Col Bajraktarit, i cili u vra së bashku me përcjellësit e tij. Të nesërmen reparatet e kësaj Brigade i zunë dy çetnikë, njëri prej të cilëve, Milisav Tomoviqi, ishte anëtar i Shtabit të Brigadës çetnike të Kollashinit.⁹³

Deri më 10 maj Brigada arriti që të kontrollojë të gjithë sektorët e kësaj zone operative. Më 15 maj grupet çetnike të Zhika Markoviqit depërtuan në sektorin Banjskë-Leposaviq dhe njësitet e Brigadës u vunë në ndjekjen e tyre, ku pas përpjekjeve disaditëshe zunë edhe udhëheqësin famëkeq të çetnikëve të kësaj ane, Lubo Radovanoviqin, ndërsa më 4. VI, 1945 u zu edhe Mirosav Radulloviqi.⁹⁴

Më 10. VI, 1945 Brigada u vendos në sektorin Podujevë-Lluzhan-Mramor. Kufiri operativ në anën perëndimore arrinte në rrugën Prishtinë-Podujevë, deri te fshati Lupç i Poshtëm e prej andej nëpër rrjedhën e lumit Kaçanullë e deri te burimi i tij. Selia e Shtabit të Brigadës u vendos në Sallabanjë Lluzhan, ndërsa batalionet u dislokuan nëpër lokalitetet përreth.⁹⁵

⁸⁸ AIUH, K-1411, nr. 9-6. (Gjatë qëndrimit në këto anë, njësitet e kësaj Brigade u ndeshën me forcat vullnetare në afërsi të Lupçit të Poshtëm, me ç'rast armiku pati një të vranë e 5 të zënë rob, ndërsa Brigada 2 të vranë dhe 4 të plagosur).

⁸⁹ AIUH, K-1411, nr. 34-4.

⁹⁰ AIUH K-1412, nr. 5-5/2.

⁹¹ AIUH K-1412, nr. 10-12.

⁹² Si shën. 91.

⁹³ Po aty.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Po aty.

Pas kryerjes së këtyre operacioneve Brigada shkoi në rrethin e Suharekës. Pas riorganizimit të Shtabit Operativ të UNÇ dhe të AP të Kosovës, që u bë më 18. VI. 1945, ajo hyri në përbërjen e Armatës V.⁹⁶

VI. Përfundim

Brigada IV e UNÇ dhe e AP të Kosovës ishte njëra ndër formacionet e para të mëdha ushtarake që u formuan në Krahinën tonë.

Kjo Brigadë në bashkëpunimin me Brigadën e III dhe të V të UNÇ të Shqipërisë si dhe me brigadat e tjera të Kosovës ka marrë pjesë në luftimet përfundimtare për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit dhe për vendosjen dhe konsolidimin e pushtetit të ri.

Brigada IV, gjatë operacioneve të zhvilluara kundër forcave vullnetare në Drenicë, arriti shumë jo vetëm në përlëshje me këto forca, por edhe në përfitim të masave, duke përdorur si armë bindjen. Kështu ajo veprroi edhe në Gjilan e rrethinë si dhe në viset në veri dhe në perëndim të Mitrovicës, me ç'rast shpartalloi definitivisht forcat e reaksionit shqiptar dhe mbeturinat e forcave çetnike.

Në Brigadë ndjehej me të madhe mungesa e kuadrove shqiptare, gjë që u reflektua në shumë aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së saj.

Brigada, e formuar në kushtet e rënda të luftës, hasi në shumë vështirësi në rrugën e saj të konsolidimit dhe forcimit organizativ-ushtarak. Kuadri komandues dhe luftëtarët në fillim nuk kishin parapërgatitje të nevojshme ideopolitike dhe taktikë ushtarake. Mirëpo, në sajë të angazhimit të forcave subjektive dhe të përkrahjes së ndihmës nga qarqet më të larta partiake e ushtarake, ajo së shpejti u aftësua dhe ishte në gjendje t'i kryente si duhet detyrat që i parashtroheshin.

Organizata partiake e kësaj Brigade luajti rol të rëndësishëm në punën organizatave, politike, propagandistike dhe edukative të luftëtarëve dhe të kuadrit komandues. Ajo në mënyrë të veçantë u angazhua për flakjen e qëndrimeve sektare të disa aktivistëve dhe eprorëve, si ndaj masave shqiptare, ashtu edhe ndaj vetë luftëtarëve dhe komunistëve shqiptarë në Brigadë, të cilët akuzoheshin për gjoja oportuniste dhe rënie në pozitat e masave.

Organizata e BRKJ ka qenë njëra nga organizatat politike më masive në Brigadë. Me angazhimin dhe aktivitetin e anëtarëve të vet, të cilët përbënin shumicën e luftëtarëve, ajo arriti të zhvillojë aktivitet të gjithëanshëm politik e edukativ, jo vetëm në gjirin e Brigadës, por edhe më gjerë.

Brigada IV e Kosovës, në sajë të angazhimit të shumicës së luftëtarëve, frymës së mirëkuptimit reciprok, guximit dhe vetëmohimit në shumë përpjekje me armikun, me plotë të drejtë u quajt *sulmuese* dhe Brigadë e vëllazërimit e bashkimit të popujve të kësaj treve si dhe Brigadë e vëllazërimit luftarak me popullin e Shqipërisë.

⁹⁶ Po aty.

Mr Muhamet Shatri

LA 4^e BRIGADE DE KOSOVA

La 4^e brigade de Kossova a été créée à Kruma de Hasl (Albanie) le 13 octobre 1944.

Cette brigade, en collaboration avec les 3^e et 5^e brigade de l'Armée de libération nationale d' Albanie et avec les autres brigades de Kossova a participé aux combats finals pour la libération de la Plaine de Dukagjin ainsi que pour l'établissement et la consolidation du nouveau pouvoir.